

UDHËZIM
Nr. 2, datë 9.2.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 28.1.2020, “PËR
PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE SHKARKIMIT TË DREJTORIT
TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2020, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Titulli i udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.

b) Shkronja “b”, e pikës 1, të kreut I/B, ndryshon me këtë përmbajtje:

“b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”, me vlerësim jo më pak se “Mirë”, në kualifikimin e fundit;”.

c) Shkronja “d”, e pikës 1, të kreut I/B, ndryshon me këtë përmbajtje:

“d) të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për të kryer atë.”.

d) Shkronja “e”, e pikës 2, të kreut I/B, ndryshon me këtë përmbajtje:

“e) certifikatën e drejtuesit të IPAP-së ose vërtetimin nga Shkolla e Drejtorëve, që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor;”.

e) Titulli i kreut II, ndryshon si më poshtë:

“Mbarimi i marrëdhënies së punës, ulja në detyrë, pezullimi dhe shkarkimi i drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.

f) Shkronja “a”, e kreut II/A, ndryshon me këtë përmbajtje:

“a) jep dorëheqjen, për arsye personale ose kur nuk pranohet për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar apo nuk certifikohet deri në 2 teste të njëpasnjëshme pas përfundimit të tij;”.

g) Pas pikës A, shtohet pika A.1 me këtë përmbajtje:

“A.1. Raste të uljes në detyrë të drejtorit të IPAP-së”.

Drejtori i IPAP-së i nënshtrohet procedurës së vlerësimit vjetor të performancës, nga ana e ZVAP-së. Në rast se pas vlerësimit vjetor drejtori rezulton me performancë jo të kënaqshme, ndaj tij merret masa disiplinore e uljes në detyrë nga DRAP-ja dhe kalim në pozicionin e punës si mësues në profilin e tij, brenda të njëjtë institucion arsimor ose në institucionin arsimor më të afërt brenda të njëjtë ZVAP”.

h) Shkronja “g”, e pikës 1, të kreut II/B, ndryshon si më poshtë:

“IPAP-ja që ai drejton ka dy vlerësime të njëpasnjëshme “Dobët.”.

i) Shkronja “j”, e pikës 1, të kreut II/B, shfuqizohet.

j) Në kreun III, pas pikës 1 shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1 Kandidati fitues për drejtor të IPAP-së, i cili nuk është certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, emërohet përkohësisht nga drejtori i DRAP-së deri në certifikimin nga Shkolla e Drejtorëve, pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit

Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Evis Kushi